

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim vendosje paisje mjekesore dhe hotelerie per sherbimin e Poliklinikes”, ndare ne tre lote.

OBJEKTI LOT I : Paisje Mjekesore per ORL, Okulistike, Fizioterapi etj,

OBJEKTI LOT II : Paisje Mjekesore Imazherike

OBJEKTI LOT III : Paisje Hotelerie per kabinetet

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

3311200-8 ; 33100000-1 ;39290000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

FONDI LIMIT: 24.999.875 (njetzet e kater milion e nenteqind e nentedhjete e nente mije e teteqind e shtatedhjete e pese) Leke pa tvsh

Fondi Limit Loti 1 :6.240.333 (gjashte milion e dyqind e dyzet mije e treqind e tridhjete e tre) Leke pa tvsh

Fondi Limit Loti 2 : 10.413.333 (dhjete milion e) Leke pa tvsh

Fondi Limit Loti 3: 8.346.209 (tetemilion e treqind e dyzet e gjashte mije e dyqind enente)Leke pa tvsh

(LOTI I)

Loti 1 - Paisje Mjekesore per ORL, Okulistike, Fizioterapi etj

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituar

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*
- b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar për periudhën që përfshin objekti i prokurimit.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 (aftësia teknike) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 2 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.1.3 Ofertuesi duhet të paraqesë për pajisjen mjekësore objekt prokurimi, çertifikatën CE ose deklaratën e konformitetit (sipas kategorizimit perkates) për aprovim të standarteve, direktivave në tregun Europian, origjinal i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejme të përcaktuar se:*

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.1.4 Ofertuesi duhet të paraqese autodeklarate që pajisja e shoqeruar me aksesoret perkates objekt prokurimi te jene te reja, te paperdorura dhe prodhim i viteve te fundit (2022-2023).

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne pikat 5, 6 dhe 8 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 "Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik", rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e tyre te jete **jo me e vogel se 40% e vlerës së fondit limit.**

Shënim: Nëse operatorët ekonomik nuk arrijnë që të paraqesin xhiron e sipërcituar për vitin 2023 për efekte të mbyllje se vitit fiskal, mund të paraqesin xhiron vjetore për vitet (2020, 2021 dhe 2022).

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" ne piken 2.10 /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DST, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162, datë 23.12.2020,"Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të

kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **40 % e vlerës së fondit limit*** për të cilat konkurron operatori, është nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatoret Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Deshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit** dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik" , ne te cilin gjejme te percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale*

e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK. **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me piken 2 te nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike: Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

2.3.3 Të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinier në stafin e vet te trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do te kryej furnizim - vendosjen e pajisjes dhe aksesorët përkatës objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave së trajnimit sipas aparatures qe furnizon, CV-së,

kontratës individuale të punës. Inxhinjeret duhet të figurojnë në listpagesa në 3 muajt e fundit para dates se hapjes së tenderit.

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës të DST.*

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.4 Ofertuesi duhet të paraqesë autodeklarate që pajisja e shoqëruar me aksesoret perkates objekt prokurimi të jete te reja, te paperdorura dhe prodhim i viteve te fundit (2022-2023).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të çilesive”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për pajisjet, në të cilën duhet të saktësojë se periudha e garancisë të jete jo më pak se 1 (një) vit, sipas afatit të përcaktuar në specifikimet teknike. Në deklaratën për përmbushjen e afatit të garancisë (një vit garanci përfshirë blerjen edhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinaleose edhe zëvendësimin e paisjes).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të çilesive”.

2.3.6 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën

shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve e konomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata I plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...]. Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise se paisjeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per pajisjen objekt prokurimi bashke me aksesoret perkates, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti ose Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter eshte ne perputhje me piken 1 te nenit 36 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se:

- 1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësore dhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky kriter eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 40 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar, ku percaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Ne kete kontekst eshte kerkuar dhe oferta teknike, me ane te se ciles do te behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, specifikimeve te tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.*

2.3.8 Operatori do te paraqese katalogun e pajisjes ku te jene shenuar (markuar) specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve e konomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë

se ata I plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (LOT I)

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Loti 1 - Paisje Mjekesore per ORL, Okulistike, Fizioterapi etj

Sasia dhe Grafiku i levrimit

Nr	Emertimi paisjes Mjekesore	Sasia cope
1	Autorefraktometer	1
2	Biomikroskop	2
3	Tonometer	2
4	Tabele Vizusi	2
5	Kuti Lentesh	2
6	Dermatoskop	1
7	Aparat ultratinguj per fizioterapi	1
8	Aparat lazer per fizioterapi	1
9	Llampe otojatrike	1
10	Aspirator per ORL	1
11	Audiometer	1
12	Spirometer	1
13	EKG	1
14	Defibrilator	1

Emertimi I paisjes dhe specifikimet

Autorefraktometer

Te kete ekran komandimi me prekje, I rrotullueshem,LCD me ngjyra, jo me pak se 6.5”

Te komandohet me joystick, me levizje ne kater drejtimet.

Te jete me printer te integruar

Te mund te mate beben e syrit duke filluar nga diametri 2 mm

Te mundesoje matjet ne diapazonet e meposhtme:

Fuqia refraktive sferike : afersisht -22D deri ne +22D, me hap afersisht 0.12D/0.25D

Fuqia refraktive e kornese : afersisht 35D deri 55D, me hap afersisht 0.12D/0.25D

Fuqia refraktive cilindrike: afersisht 0D ~ ±10D, me hap afersisht 0.12D/0.25D.

Fuqia refraktive e kornese : afersisht 0D deri ±14D, me hap afersisht 0.1.

Diapazoni i matjes se distances pupilare afersisht ne rangun 30mm deri 85mm

Kendi Aksial astigmatik : 0 ~ 180°

Kendi Aksial astigmatic I kornese: 0 ~ 180° ,

Te jete I pajisur me auto tracking

Te jete I pajisur me funksionin autoshkrepje

Te mundesoje transmetim te dhenash me USB , RS-232 ose LAN.

Te kete mundesi per tu lidhur me sistem menaxhimi te te dhenave optike.

Furnizimi me energji 100-240 V, 50/60 Hz.

Biomikroskop

Te mbuloje te gjithë aspektet e ekzaminimit te syrit.

Te siguroje cilesi/ qartesi ne lidhje me imazhin

Te garantoje komoditet ne lidhje me perdorimin e pajisjes nga perdoruesi ndaj pacientit.

Te jete i pajisur me mbajtesen e tonometrit

Te mund te pozicionohet (horizontalisht/vertikalisht)

Te jete pajisur me te gjithë aksesoret e nevojshem

Blloku i ushqimit te funksionoj ne: 100-240 V AC, 50-60 Hz

Mikroskopi te kete specifikimet

Zgjedhja e shkalles se zmadhimit te realizohet nepermjet nje rrotulle (knob) te komandueshme .

Te siguroje shkallet e zmadhimit (magnification) te pakten 10X, 16X, 25X

Diapazoni I rregullimit te syve te jete minimalisht ne rangun -5D ne +5D (D=diopri).

Rregullimi I distances pupilare te jete ne rangun 50 mm -80 mm

Njesia Ndricimit

Te jete ndricim LED

Te kete te pakten filtrate si RF (red-free), Blu (kobalt), densiteti neutral, difuzues , te Kuq

Gjeresia e prerjes (slit) te jete minimalisht ne rangun 0-12 mm manovrueshme gradualisht.

Gjatesia e prerjes te jete minimalisht ne rangun 1-12 mm e manovrueshme gradualisht.

Diametri I hapjes se diafragmes te jete afersisht \varnothing 12,9,5,3,2,1,0.2 mm

Tendenca e prerjes (slit-inclination) te mundesohet te pakten ne 90 0

Temperatura e drites 3100 K- 3800K

Llampa e ndricimit te jete LED, me jetegjatesi me shume se 10,000 ore pune

Tavolina Mbeshtetese

Tavolina te jete lehtesisht e transportueshme

Te jete e pajisur me rrota te cilet te jene me mekanizem frenimi

Tavolina te jete elektrike me lartesi te rregullueshme

Te kete material rezistent ndaj desinfektimit

Te kete sipërfaqe te mjeftueshme per aparaturen aktuale (biomikroskop) si dhe aksesoret perkates

Aksesore : 1 cope Lente diagnostike 90D dhe 1 cope lente diagnostike 3 pasqyrore

Tonometer

Tonometër për matjen e presionit intraokular pa kontakt me syrin.

Pajisja duhet te kete nje diapazon të kalibruar te matjes nga 0 mmHg deri në 60 mmHg me tolerance $\pm 0,5$ mmHg

Ndriçimi duhet të jete në infra të kuqe

Distanca e punes se pajisjes te jete jo me shume se 22mm

Furnizimi me energji elektrike duhet 220V -240V ne 50Hz

Pajisja duhet te jete e pajisur me printeri termik.

Tabele vizusi

Tabele vizusi me shirit të kuq dhe jeshile testi per shikimin

Te mundesoj nje distance e punës te pakten 3 m

Përmasat e tabelese te jene perafersisht 23 x 35 cm

Kuti Lentesh

Set Lentesh dhe skelet universal për ekzaminimi refraktiv te syve

Të paktën 100 copë lente te tipit sferë të ndara ne 50 copë lente konvekse dhe 50 copë lente konkave (me nje diapazon nga $\pm 0,25$ deri në $\pm 20,00$).

Lente cilindrike të paktën 40 copë të ndara 20 copë lente konveks dhe 20 copë lente konkave (me nje diapazon nga $\pm 0,25$ deri në $\pm 6,0$).

Të paktën 10 cope lente te tipit prism

Te shoqerohet me te gjitha aksesoret e nevojshem (lente te kuqe, lente te gjelbra, lente te errata, skeleti per prove etj.).

Ne skelet duhet te venosen te pakten 4 lente në kornizën e majtë dhe të djathtë.

Dermatoskop

Dermatoskop për të diagnostikuar gjendjen e lëkurës

Gjatësia e krahut e rregullueshme me nje diapazon 35+35 cm ose më shumë

Lartësia e trolley duhet te jete te pakten ne diapazonin: 80-95 cm

Lente zmadhuese prej qelqi me një dioptri minimum 3

Llambë duhet te jete fluoreshente ose LED me një fuqi të përafërt 3-9W

Gjatësia e valës së llambës në intervalin 360-395 nm për ekzaminim efektiv të lëkurës

Tensioni i punes: 220-240 V, 50 Hz për furnizim standard me energji elektrike

Aparat me ultratinguj per fizioterapi

Aparat me ultratinguj per fizioterapi (për trajtime terapeutike)

Te jete e pajisur me një ekran me prekje me ngjyra jo më pak se 7"

Te kete të paktën një kanal për terapi të pavarur

Pajisja duhet të operoje manualisht ose nga programi.

Pajisja dhet të ketë një bazë të dhënash të integruar me programe të paracaktuara për terapi.

Pajisja duhet të lëshojë valë, impulse ose te vazhduar

Pajisja duhet të ketë mundesine për të rregulluar frekuencën në modalitetin impulse ne 16 Hz, 48 Hz, 100 Hz.

Sondat duhet të jetë e papërshkueshme nga uji. Gjithasthu te gjeneroje valë ultratinguj 1 MHz dhe 3 MHz

Duty factor në modalitetin e pulsit te jete 5 - 75 %, me nje hap 5%

Aksesorë shtesë:

Aplikues me sipërfaqe 1cm²

Aplikues me sipërfaqe 4cm²

Syzet mbrojtëse

Aparat lazer per fizioterapi

Pajisje per terapi lazer me fuqi te larte per trajtimin e semundjeve dhe demtimeve muskuloskeletale.

Pajisur me ekran me prekje me ngjyra jo më pak se 5"

Pajisur me të paktën nje kanal për terapi të pavarur

Pajisja duhet të funksionojë në mënyrë manuale ose me program.

Duhet të ketë nje databaze të integruar me programe të paracaktuara për trajtim.

Mënyra e operimit të jetë e vazhdueshme pulsative dhe superpulsative.

Aparati duhet të ketë mundesi për rregullimin e fuqisë së rrezatimit të laserit.

Pajisja te kete mundesi te punoje si laser me fuqi të lartë dhe biostimuluese.

Gjatesia e vales dhe fuqia ne modalitet biostimuluese duhet te jete perafersisht: 700nm - 800nm me fuqi perafersitsh 350mW

Gjatesia e vales dhe fuqia ne modalitet fuqie te larte duhet te jete perafersisht: 800nm - 1000nm me nje fuqi - 10W

Pajisja duhet te mundesoje testimin automatik të fuqisë së rrezatimit.

Gjatësia e vales se sondave duhet të jetë në gamën e perafert 650 deri në 1000 nm.

Aksesore shtesë:

Dy aplikatore me gjatesi vale te ndryshme

Dy aplikatore me gjatesi vale te ndryshme

Syze mbrojtëse

Llampe otojatrike

Llampe për të ekzaminuar anatominë e veshit

Instrumenti te jete i ndërtuar nga materiale rezistente

Me një ndriçim me llambë LED që varion nga 7500 në 10,000 LUX

Me një jetëgjatësi të perafert te llampes 50,000 orë

Te kete nje lente zmadhimi 3X

Temperatura e llampes duhet te jete midis 4,500-6,000°K

Indeksi i lartë i interpretimit të ngjyrave mbi 70

E pajisur me bateri te karikueshme me pavaresi nga 5-12 ore dhe karikues baterish

Aspirator per ORL

Aspirator per ORL , per aspirimi e lëngjeve trupore.

E pajisur me një rregullator vakumi.

Shpejtësia e rrjedhjes së ajrit minimumi 40 litra në minutë.

Presioni maksimal i thithjes të paktën 400 mm/Hg ose më i lartë.

Treguesi i vakumit për monitorimin e fuqisë së thithjes.

Kapaciteti i shishes: 1000 - 2000 ml, material rezistence

Cikli i funksionimit: I vazhdueshëm për përdorim të pandërprerë.

Portabel

Niveli i zhurmës nuk duhet të kalojë 65 dBA

Te autoklavohet në 121°C për sterilizim të lehtë dhe efektiv.

E pajisur me valvul kontrolli për të parandaluar tejmbushjen.

Tensioni i funksionimit 230 V - 50 Hz.

Audiometer

Pajisja për të kryer ekzaminime audiometrike ne Ajer, Kocke dhe Masking

Pajisja duhet te jete e aftë për të gjeneruar tone të pastra dhe tone të lëkundshme.

Pajisja duhet te kete dy hyrje të jashtme për te kryer ekzaminime audiometrike e të folurit.

Range i zbutjes se tonit duhet te jete 1 dhe 5 dB

Pajisje duhet te kete modalitetet e vazhdueshme dhe pulsuese qe duhe te variojne ne nje range 0,5, 1 dhe 2 Hz.

Pajisja duhet te kete sinjalin modulues te valës sinusoidale 5 Hz

Tipi AC duhet te jete te përputhshme me kufjet TDH-39 dhe DD45

Tipi BC te jete për testimin e përcjellshmërisë së kockave (vibrues kockor B-71)

Pajisja duhet te kete range te gjerë te frekuencës nga 125 në 8000 Hz

Pajisja duhet te kete nje ekran LCD me një madhësi minimale prej 4 inç.

Pajisja duhet te kryej keto teste: audiometria e Tonit të pastër, pragu automatik i Hughson-Westlake, audiometria e të folurit me 2 kanale, Indeksi i ndjeshmërisë me rritje 1 dB, testi stenger me stimulim të pastër të tonit, zbërthimi i tonit me kohëzgjatje 60 ose 120 sekonda, diferenca me Limen 0 intens dhe 5 dB, 2 kanale të pavarura për vlerësimin kryesor të aparatit të dëgjimit.

Te kete nje kapacitet te ruajtjes deri në 100 pacientë

Te kete mundesi për dhe transferim të pandërprerë të dhënave ne software te dedikuar.

Pajisja duhet te perfshije mikrofon te integruar ose te jashtëm, altoparlant te integruar ose kufje me mikrofon per te mundesuar komunikim ndermjet pacientit dhe operatorit.

Rangu i intensitetit AC te jete nga -10 deri në 100 dB dhe BC nga -10 deri në 70 dB.

Aksesorët te perfshire:

Kufje TDH-39 ose DD45, vibrues kockash B71, pulsanti I përgjigjes së pacientit dhe një kufje me mikrofon për komunikimin pacient-operator, printer .

Spirometer

Spirometer per matjen e funksionit pulmonar dhe për vlerësim të saktë të funksionit të mushkërive.

Një ekran me prekje me ngjyra me një madhësi nga 5- 7 ".

Pajisja duhet te kete nje memorie minimum per testet spirometrike.

Pajisja duhet te kete nje game te gjerë e parametrave duke përfshirë kapacitetin vital të detyrueshëm (FVC), kapacitetin vital (VC), dhe ventilimin maksimal (MVV) .

Opsioni i oksimetrisë te jete i mundur për të rriturit dhe fëmijët.

Pajisja duhet te punoje me shume se 1 orë me bateri te pavarur nga energjia elektrike.

Sensori dixhital i turbinës duhet te jete me dy drejtime që te siguroj matje të saktë dhe të saktë të rrjedhës së ajrit.

Gama e rrjedhës te testimi dinamike dhe të gjithanshme jete të paktën $\pm 16L/s$ ose $200mL/s$.

Te kete nje saktësi matje te vellimit prej të paktën 50 ml

Te kete nje rezistencë dinamike më pak se $0,6 \text{ cm H}_2\text{O/L/s}$ për ndërhyrje minimale me modelet natyrale të frymëmarrjes.

Gojza e aparatit te kete nje diametër prej të paktën 30 mm për rehati dhe lehtësinë e përdorimit të pacientit.

Saktësia e ngopjes me oksigjen (SpO2) prej të paktën $\pm 2\%$, duke siguruar monitorim të saktë të niveleve të oksigjenit në gjak.

Te kete printer termik te inkorporuar dhe bateri te inkorporuar te rikarikueshme. Gojeza me nje perdorim 100 cope

EKG

Pajisje Ekg e programueshme me 12 kanale me interpretim

Pjaisje duhet te jete e programueshme ne modalitetet e resting EKG, arritmia dhe exercise.

Te kete mundësi te programimit për skanime të ndryshme dhe interpretim të rezultateve.

Te kete nje ekran LCD me një madhësi minimale prej 7.0".

Te jete e pajisjur me nje printer termik i integruar

Pajisja duhet te kete nje autonomi jo më pak se 2.5 orë për përdorim pa lidhje elektrike.

Impedanca e hyrjes te barabarte ose më te madhe se $10 \text{ M}\Omega$ ne 10Hz

Përgjigja në frekuencë duhe te jete në rangun 0.05 - 145 Hz.

Common Mode Rejection Ratio më e madhe se 100 dB.

Nivelet e amplifikimit të jener në shkallën 2.5 mm/mV; 5 mm/mV; 10 mm/mV; 20 mm/mV

Te këto nivele të ulët të rrjedhjes të rrymës në pacient, jo më shumë se 12 µA në kushtet normale.

Te jete e pajisur me mbrojtje nga defibrilatori për sigurinë e pajisjes dhe pacientit.

Aksesoret

Kabëll EKG dhe Elektroda ekg të përfshira në paketë.

Defibrilator

Defibrilator me goditje të sinkronizuar

Madhësia e ekranit të pajisjes duhet të jetë paktën 6,5 "

Kapaciteti i ngarkesës me një bateri të re të ngarkuar plotësisht duhet të sigurojë të paktën 100 cikle ngarkimi/goditjeje me fuqi të plotë.

Forma e valës duhet të jetë bifazik për një efikasitet optimal në trajtimin e aritmive.

Energjia maksimale e aparatit duhet të jetë në rangun 0-360 Xhaul, për të mbuluar nevojat e ndryshueshme të trajtimit.

Saktësia e aparatit duhet të jetë të paktën $\pm 15\%$ ose $\pm 1J$.

Më pak se 8 sekonda, aparatit në bateri të plote duhet të kapë një energji prej 200 Joules.

Më pak se 10 sekonda, aparatit në bateri duhet të kapë një energji deri në 360 Xhaul.

Impedanca e pacientit duhet të jetë në rangun min: 25 ohm - maks: 170 ohm.

Aparati duhet të ketë funksionin e "goditjes së sinkronizuar" për një trajtim të përshtatshëm dhe të koordinuar me ritmin e zemrës.

Aparati duhet të mundesojë njoftimet me tekst, sinjalizimet audio, sinjalet QRS, statusi i baterisë, gati për përdorim (RFU), energjia elektrike, modaliteti i sinkronizimit etj.

Aparati duhet të ketë treguesin e gjendjes "gati për goditje"

Modaliteti me AED është e mundur me një nivel energjie prej të paktën 200 J, për një trajtim efikas në raste të emergjencave kardiake.

Deri në 12 valë EKG mund të shihen në ekran, ofruar një pamje të detajuar të aktivitetit kardiak.

Leximi dixhital i rrahjeve të zemrës në ekran nga 20 deri në 300 rrahje/minutë (të rritur), me një saktësi ± 5 rrahje/minutë, dhe me një rezolucion 1 rrahje/minut për të siguruar për monitorimin e saktë të ritmit kardiak.

Impedanca në hyrje të jete të pakten 5M ohm ose me shume.

Aksesore shtesë: kabell EKG

➤ Afati i levrimit do të jete 45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

- Operatori do të kryejë furnizimin , instalimin dhe testimin e aparaturave me kostot e tij.
- Operatori duhet të trajtoj stafin mjekesor pas instalimit të pajisjeve mjekesore ne kabinetet perkatese

(LOTI II)

Loti II - Furnizim –Vendosje - Paisje Mjekesore Imazherike

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1;**

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas **Shtojces 2;**

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituar

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8;**

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3;**

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*
- b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar për periudhën që përfshin objekti i prokurimit.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 (aftësia teknike) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 2 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.1.3 Ofertuesi duhet të paraqesë për pajisjen mjekesore objekt prokurimi, çertifikatën CE ose deklaratën e konformitetit (sipas kategorizimit përkatës) për aprovim të standarteve, direktivave në tregun Europian, origjinal i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejme të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”,

rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e tyre te jete **jo me e vogel se 40% e vlerës së fondit limit.**

***Shënim:** Nëse operatorët ekonomik nuk arrijnë që të paraqesin xhiron e sipërcituar për vitin 2023 për efekte të mbyllje se vitit fiskal, mund të paraqesin xhiron vjetore për vitet (2020, 2021 dhe 2022).*

***Shënim*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 /ose/ 2.14*

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DST, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162, datë 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejmë te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosija e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **40 %**

e vlerës së fondit limit* për të cilat konkurron operatori, është një deshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zoterojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.4.1 Deshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" në piken 2.10 / 2.14.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësia. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të*

kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK. **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.4.2 Të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinier në stafin e vet te trajnuar për pajisjet mjekesore i cili do te kryej furnizim - vendosjen e pajisjes dhe aksesorët përkatës objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave së trajnimit sipas aparatures qe furnizon, CV-së, kontratës individuale të punës. Inxhinjeret duhet te figurojne ne listpagesa ne 3 muajt e fundit para dates se hapjes se tenderit.

* *Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës të DST.*

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.4.3 Ofertuesi duhet të paraqesë autodeklarate që pajisja e shoqëruar me aksesoret perkates objekt prokurimi të jete te reja, te paperdorura dhe prodhim i viteve te fundit (2022-2023).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të çelësive”.

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për pajisjet, në të cilën duhet të saktësojë se periudha e garancisë të jete jo më pak se 2 (dy) vite , sipas afatit të përcaktuar në specifikimet teknike.Në deklaratën për përmbushjen e afatit të garancisë (dy vite garanci përfshirë blerjen edhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinaleose edhe zëvendësimin e paisjes).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të çelësive”.

2.4.5 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve e ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...]. Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpunueshmërisë së paisjeve mjekësore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesoret perkates, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti ose Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter eshte ne perputhje me piken 1 te nenit 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësore dhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky kriter eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 40 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ku percaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Ne kete kontekst eshte kerkuar dhe oferta teknike, me ane te se ciles do te behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, specifikimeve te tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.

2.4.7 Operatori do te paraqese katalogun e pajisjes ku te jene shenuar (markuar) specifikimet teknike. Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve e konomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata I plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (LOT II)

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

(LOTI II)

Loti II - Furnizim –Vendosje - Paisje Mjekesore Imazherike

Sasia dhe Grafiku i levrimit

Nr	Emertimi paisjes Mjekesore	Sasia cope
1	Aparat grafie stacionare	1
2	Eko Abdominale	1

Specifikimet Teknike

Aparat Grafie Dixhitale
Aparat grafie i montuar ne dysHEME
Me gjenerator me frekuence te larte
Te jete i kontrolluar me mikroprocesor
Me kontroll te KV, mA, Kohe/mAs
Me sistem mbrojtjeje per mbingarkesen se llampes
I perbere nga: Gjeneratori i rrezeve-X Stativi i Llampes se rrezeve-X Kolimatori Tavolina me Bucky horizontal Bucky Vertikal Receptor Imazhi dixhital (2 cope) Konsoli qendror i pajisur me njesine e perpunimit dhe regjistrimit te imazheve
Gjenerator I frekunces se larte I cili realizon diagnostifikime me cilesi te larte imazhi. Frekuenca me e madhe se 100kHz
Fuqia e gjeneratorit 50kW
Pajisur me funksion AEC per optimizim automatik te rrezatimit
Rryma radiografike maksimale: deri ne 630mA
Diapazoni i mAs afersisht nga 0.1-630mAs
Koha e ekspozimit maksimale ndaj rrezeve X duhet te jete me e vogel se 7 ms
Tensioni Radiografik: 40-150kV
Voltazhi i Llampes minimalisht 150kVp
Spoti fokal minimal 0.6
Spoti fokal maksimal 1.2
Sistem me ftohes se llampes
Kapaciteti i ruajtjes se nxehtesise se anodes jo me i vogel se 300 kHU
Pajisur me filter fiks (te perhershem) 0.9mmAl ose ekuivalent
Qenderzimi ne kolimator me rreze laser per pozicionim me tregues LED
Mbajtesi i llampes se rrezeve X me kolone te levizshme per llamben e rrezeve X
I pajisur me levizje Vertikale dhe Horizontale te krahut te tubit dhe me frena elektrike
Rrotullimi i Tubit 360 °. I pajisur me frena elektrike
Diapazoni i levizjes vertikale rreth 150cm
Tavolina Radiografike me Bucky
Tavolina me suprinen e siperme te levizshme me frena elektrike
Permasat e suprinës se tavolines perafersisht 210 x 75 cm ±10%
Diapazoni transversal i levizjes se tavolines: rreth 30 cm ±5cm ose me mire

Diapazoni gjatesor i levizjes se tavolines: rreth 60 cm \pm 10cm, ose me mire
Pesha mbajtese rreth: 160 Kg toleranca +15%
Bucky Vertikal. Diapazoni i levizjes vertikale rreth 140 cm \pm 10cm
Pajisur me dy Receptore Imazhi te sheshte me teknologji dixhitale te avancuar (bucky horizontal+vertikal)
Paneli i Imazhit:43X43 cm, pa rrotullim
Pixel Matrix: afersisht 3000x3000. Eficenca e konvertimit te pakten 70%.
Pixel Pitch: jo me shume se 140 μ m \pm 5 μ m
Me sistem te kompjuterizuar per marrjen dhe perpunimin e te dhenave
Software per marrjen e te dhenave, Lidhje PACS dhe/ose DICOM 3.0
Pajisur me protokolle per cdo pjese te trupit.
Pajisur me funksione matje dhe perpunimi te imazheve
Me module diagnostikuese, program per imazhe, ndertimi i listes se punes, printim, DICOM, profile te ndryshueshme, ruajtje e imazheve. Import /eksport imazhe, Krahasim Imazhe, Ekran i Plote (full screen), Auto Kolimator, Pranim ose Refuzim te Imazheve, etj.
Njesia kompjuterike duhet te kete karakteristikat minimale meposhte:
Sistem Operimi MS Windows ose ekuivalent
Procesor dual core ose me i mire, min 4 GB RAM, 1TB hard disk ose me shume
Monitor i sheshte 23"
Garancia 2 vjet
Eko Multidisiplinare
Aplikime Gjinekologjike, Obstetrike, Abdominale, Kardiake, Vaskulare, Urologjike, Inde te buta Pediatrike dhe Muskuloskeletale.
Frekuencat e funksionimit te sistemit: 2 deri ne 18 MHz
Mbi 200,000 kanale dixhitale procesimi
Te kete te pakten 3 porta per sonda aktive.
Te shoqerohet me UPS per autonomi operimi ne mungese te energjise elektrike per rreth 15 minuta.
Menyrat e operimit: M, 2D, 3D, 4D, PD, PWD, Color Doppler.
Monitor me ngjyra (LCD/LED). Madhesia e ekranit mbi 21", me rezolucion te larte.
Paneli i kontrollit me ekran (LCD/LED) me prekje, per kontroll funksional. Madhesia: mbi 12" diagonal.
Shfaqja e imazhit: single/dual/quad, me 256 nuanca grije.
Intervali Dinamik maksimal mbi 250 dB
Thellesia e fushes se skanimit: te pakten 0-32 cm
Perfshin funksione cine me memorizim te shume cikleve mbi 70,000 imazhe
Funksione automatike per permiresimin e rezolucionit, kontrastit dhe per rregullimin automatik te spektrit doppler (linja baze, frekuenca PRF, etj.)
Shpejtesia maksimale e nderrimit te imazhit mbi 1700 frames/sec
Shfaqja e imazhit: 2D-Mode, M-Mode, Color M Mode, Color Doppler, Doppler fuqie (PD), 3D-Mode, 4D-Mode, Harmonic Imaging. Compound Imaging. Trapezoidal imaging., Doppler Spektral (PWD), Doppler Spektral (CWD)
Color Doppler. Amplifikim deri ne 40dB. Perthyerje e kendit te skanimit ne 6 nivele \pm 10°, \pm 15° dhe \pm 20°.
Color Doppler PRF 0.3 – 18 KHz
Mundesi selektimi deri ne 10 ose me shume harta ngjyre.

Power Doppler. Amplifikimi deri ne 40dB
Doppler Spektral PWD. Intervali i frekuences 0.3 – 18 KHz. Shpejtesia: 0.2 -700 cm/s. Amplifikimi deri ne te pakten 80dB.
Funksion per ekzaminime ekografike me kontrast nepermjet sondes konvekse.
Te perfshihet funksion software per ekzaminime panoramike me gjatesi skanimi mbi 50cm.
Te perfshihet funksion software per ekzaminime Elastografie me sonden konvekse dhe lineare.
Software per administrimin e te dhenave te pacienteve sebashku me database
Software per permiresimin e kontureve te imazhit, diferencimin indor dhe reduktimin e artefakteve
Filter per reduktimin e artefakteve me definicion te larte me te pakten 5 shkallezime
Te Perfshihen Sondat:
Sonde konvekse 2D, Multifrekuence 2-5 MHz, Teknologji e avancuar per depertim dhe rezolucion maksimal. Fushepamje minimale 60° ±2°. Aplikimet: Abdomen, OB-GYN, Urologji, Torakale, Intervencionuese (pranon guida biopsie), Muskuloskeletale dhe Pediatrike.
Sonde lineare 2D, Multifrekuence 4-12 MHz. Teknologji e avancuar per depertim dhe rezolucion maksimal. Fushepamje minimale rreth 40mm ± 2mm. Aplikimet: Vaskulare, Muskuloskeletale, Tiroide, Intervencionuese (pranon guida biopsie) dhe Pediatrike.
Memorje e brendshme me teknologjine e fundit SSD me te pakten 500 GB kapacitet
Pajisur me 4 porta USB
Pajisur me porte Ethernet
Pajisur me Video Printer Bardh e Zi
Garancia 2-vjet

- Afati i levrimit do te jete 45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës
- Operatori do te kryeje furnizimin , instalimin dhe testimin e aparaturave me kostot e tij.
- Operatori duhet te trajnoj stafin mjekesor pas instalimit te pajisjeve mjekesore ne kabinetet perkatese

(LOTI III)

LOT III Paisje Hotelerie per kabinetet .

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.
2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi: Kjo shtojce është pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituar

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8:

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen është e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Sistemit të menaxhimit të cilësisë së punimeve ISO 9001- 2015 ose ekuivalente (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente*

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 ose ekuivalente (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Sistemit të menaxhimit të rrezeqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë ISO 45001-2018 ose ekuivalente (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e tyre te jete jo me e vogel se 40% e vlerës së fondit limit.

Shënim: Nëse operatorët ekonomik nuk arrijnë që të paraqesin xhiron e sipërcituar për vitin 2023 për efekte të mbyllje se vitit fiskal, mund të paraqesin xhiron vjetore për vitet (2020 ,2021 dhe2022).

Shënim: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilen ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 /ose/ 2.14*

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DST, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162, datë 23.12.2020, ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe,

sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*; Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **40 % e vlerës së fondit limit* për të cilat konkurron operatori, eshte nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatoret Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Deshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit** dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilin eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një staf punonjësish jo me pak se 10 (dhjete) persona për periudhën – Muaji i fundit i deklaruar. Me qëllim plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqesë listëpagesat e periudhës së kërkuar të firmosur dhe vulosur nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tyre të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme , CV, diplomë përkatëse si dhe të rezultojë në listëpagesë për muajin e fundit të deklaruar, ose të kontraktuar me kohe të pjesshme 1 (një) Arkitekt Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për realizimin e procedurës së prokurimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara, nga autoritetet përgjegjëse shtetërore gjithashtu dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve si më poshtë:
 - Mekanik 1 (një) ose Teknik 1(një)
 - Mobilier / Montator 2 (dy)
- Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier",e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës të DST.*

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti me kapacitet mbajtës jo më pak se 3.5 ton të përshtatshëm për transport të këtyre lloj paisjeve. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qera:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

Kontratë qiraje.

Leje qarkullimi e mjetit;

Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;

Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

Leje drejtimi automjeti, për të paktën 1 (një) prej punonjësve.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës të DST.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me piken 4 te nenit 77 dhe nenit 123 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohen se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin.

*2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.”*Si dhe ne perputhje me VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku përcaktohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: dhe/ ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

dhe pika 6: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*Konkretisht, ky kriter është vendosur në mënyrë që AK te sigurohet mbi kapacitetin teknik dhe profesional te OE per te permbushur sipas kerkesave objektin e kontrates per sherbimin e prokuruar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktorë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronësi/qira/përdorim

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 4 të nenit 77 dhe nenit 123 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohen se “1. Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin.2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.” Si dhe në mbështetje me VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 4 ku përcaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. dhe pikën 6, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme

për ekzekutimin me sukses të kontratës. Konkretisht, ky kriter është vendosur në mënyrë që AK të sigurohet mbi ekzistencën e ambientit të lavanderisë dhe të mund të ushtroj kontrollet e nevojshme të cilat garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

2.3.7 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin mostra të cilat duhet të dorëzohen 1 orë përpara hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor. Lista e mostrave që duhet të paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhëna në DST, të jetë:

1. Mostër 1 (një) copë - Shtrat vizite (artikulli nr 2 në listë)
2. Mostër 1 (një) copë- Tavolinë kompjuteri + komedinë (artikulli nr 5 në listë)
3. Mostër 1 (një) copë- Karrige e thjeshtë statike pa krahë mbështetës (artikulli nr 7 në listë)
4. Mostër 1 (një) copë- Raft për dosje (Etazher) (artikulli nr 10 në listë)

Mos paraqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, përben kusht për skualifikim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/a të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e percaktuar se : Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Shenim: Tolerancat e pajisjeve të hotelerisë për pajisjet me materiale druri, janë ± 2 cm.

Tolerancat për pajisjet të hotelerisë me perberje metalike janë ± 1 cm.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (LOT III)

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOT III Paisje Hotelerie për kabinetet .

Loti 3 - Paisje Hotelerie për kabinetet .

Sasia dhe Grafiku i levrimit

Nr	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia
1	Paraventë (ndarëse ambjenti)	copë	1
2	Shtrat vizite	copë	22
3	Poltron (Për EEG)	copë	1
4	Tavolinë pune për Infermier	copë	23
5	Tavolinë kompjuteri + komedinë	copë	21
6	Karrige e thjeshtë statike pa krahë mbështetës	copë	81
7	Karrige statike me krahë mbështetës	copë	12
8	Raft për dosje (Etazher)	copë	22
9	Dollap rrobash për zyra(Garderobë)	copë	22
10	Dollap magazine me tre kanata	copë	2
11	Stola pritje 3 vendësh (Metalik)	copë	25
12	Varëse rrobash	copë	19
13	Reception	copë	1
14	Tavolinëmbledhje ovale	copë	1
15	Perde roller me mekanizëm.	m ²	99,85
16	Tabela për identifikimin e dymve	copë	77
17	Tabela informacioni	copë	4


Afati i levrimit të jetë 45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Specifikimet Teknike


3. SHTRAT VIZITE	
Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):	190x60x75cm

2 PARAVENTË (NDARËSE AMBIENTI)


4. TAVOLINË PUNË PËR INFERMIER

<p>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):</p>	<p>90 x 80 x 75 cm</p>
<p>Karakteristikat kryesore të produktit:</p>	<p>Paraventë me strukturë Skeleti inoxi, të këtë 4 këmbë të cilat duhet të jenë të paisura me gomina për të realizuar fiksimin në tokë. Syprina melaminë me trashësi 25mm. Melamina e trashësisë 25 mm. Lartësia e paraventit nga toka 200 cm. Platforma të jetë e përbërë është me shtresë laminatit kundër gërvishtjes, goditjeve dhe rezistente ndaj ujit. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe lehtësisht nga njollat. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rende. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që kontratës bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në Cope</p> <p>Çmontimi dhe montimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rende. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që kontratës bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në Cope</p> <p>Çmontimi dhe montimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rende. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që kontratës bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në Cope</p>
<p>Elementë të tjerë shtesë:</p>	<p>me me regjistrim mekanik dhe pjesa tjetër fikse. Platforma të jetë e Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe ekologjike (antibakterile dhe antialergjike), rezistente nga përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Ujit dhe e pastrueshme lehtësisht nga njollat.</p>
<p>Standardi ku bazohet:</p>	<p>mi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos</p>
<p>Shembuj foto të produktit:</p>	<p>çmontimi i saktë</p> 
<p>Njësia e produktit:</p>	<p>me sfungjer me injektim</p>
<p>Elementë të tjerë shtesë:</p>	<p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese. Ujit dhe e pastrueshme lehtësisht nga njollat. Ulësja është montuar mbi një bazament metalik, në të cilën janë të montuara dy doreza për mbështetjen e duarve.</p> <p>Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.</p>


5.TAVOLINË KOMPJUTERI+KOMEDINË

Përbëhet nga 2 pjesë kryesore: <i>-Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi):</i> <i>-Komedinë me përmasa:(gjatësi x gjerësi x lartësi):</i>	Copë 140x80x75 cm 45x50x60 cm
Karakteristikat kryesore të produktit:	<p>Syprina melaminë me trashësi 25mm. Melamina e trashësisë 25 mm është me shtresë laminati kundër gërvishtjes, goditjeve dhe rezistente ndaj ujit.Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë me material ABS. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Tavolina montohet me bulonerë të fshehura. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablove nga lart poshtë dhe anasjelltas.</p> <p>Struktura e komedinës do jetë melaminë me trashësi 18 mm. Komedina dhe kapakët ballore të sirtarëve duhet të jenë prej material melamine me spesor 18mm. Bordet anësore të jenë me material plastik ABS. Komedina duhet të ketë 4 rrota në fund dhe të mund të lëvizë lirshëm nën tavolinë. Përbëhet nga 3 sirtarë nga te cilët i pari të jetë i pajisur me çelës që të realizojë mbyllje e tij. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarieres.</p>
Elementë të tjerë shtesë:	Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
Standardi ku bazohet:	
Shembuj foto të produktit:	 <p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</p>

Njësia e produktit:	Copë
---------------------	------


6.KARRIGE E THJESHTE STATIKE PA KRAHE MBESHTETES (Stafi)	
Karakteristikat kryesore të produktit:	Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostатike. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike.
Elementë të tjerë shtesë:	Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
Standardi ku bazohet:	- .
Shembuj me foto të produktit:	 <p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</p>
Njësia e produktit:	Copë

5. KARRIGE STATIKE ME KRAHË MBËSHTETËS (Salla e mbledhjeve +Recepsioni)	
Karakteristikat kryesore të produktit:	Karrigia duhet të jetë me strukturë metalike, bazament mbështetës në formë U, me përmasa ndenjësja 46 cm x 47 cm, shpinorja të jetë në formë të harkuar me përmasa 60 cm x 48 cm. Gjatësia e shpinores duhet të zbrësë poshtë nivelit të ndenjësës. Përmasat e bazamentit mbështetës 57 cm x 47 cm. Lartësia totale të jetë 94 cm. Shpinorja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshur me lëkurë ekologjike.
Elementë të tjerë shtesë:	Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Dorezat të jenë të harkuara metalike. Pjesët e sipërme të dorezave të jenë të veshura me lëkurë ekologjike me mbushje. Struktura mbajtëse e hekurit të jetë e lyer me ngjyrë sipas kërkesave të AK-së. Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
Standardi ku bazohet:	-
Shembuj foto të produktit:	 <p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</p>
Njësia e produktit:	Copë


6. RAFT PËR DOSJE (ETAZHER)	
Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):	90x 45 x 180 cm
Karakteristikat kryesore të produktit:	Skeleti dhe sergjenët do jenë prej melamine e trashësisë 25 mm është me shtresë laminati kundër gërvishitjes, goditjeve dhe rezistente ndaj ujit. Kapakët janë me material melamine me spesor jo më pak se 18 mm. Bordet anësore të skeletit, sergjenëve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik ABS. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali dru-melaminë, me trashësi jo më të vogël se 18mm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjeni me lartësi të regjistrueshme. Hapësira e sipërme do ndahet në tre hapësira me anë të sergjenëve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Etazheri qëndron mbi 4 këmbë të cilat mundësojnë pastrimin e lehtë të dyshemesë poshtë etazherit. Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali të kromuar. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë me bulonerë të fshehur.
Elementë të tjerë shtesë:	Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Rafti të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
Standardi ku bazohet:	-
Shembuj foto të produktit:	 <p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</p>
Njësia e produktit:	Copë

7. DOLLAP RROBASH PËR ZYRA (GARDEROBË)	
Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):	90x 45 x 180 cm

16.VARËSE RROBASH	
Karakteristikat kryesore të produktit:	Varësja e robave duhet të jetë praktike, funksionale dhe estetike. Koka duhet të jetë e pajisur me 5 ganxha mbajtëse dhe 5 varëse të harkuara.
Elementë të tjerë shtesë:	Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
Shembuj foto të produktit:	 <p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</p>
Njësia e produktit:	Copë

17. RECEPTION	
Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):	280*70*75/110h cm
Karakteristikat kryesore të produktit:	<p>Receptioni përbëhet nga syprina e madhe 280*70cm mbi të cilën qëndron syprina e vogël në lartësinë 38 cm me dimensione 280*30. E gjithë mobilja do të ndërtohet me material melaminë 25mm. Materiali melaminë e trashësisë 25 mm është me shtresë laminati kundër gërvishtjes, goditjeve dhe rezistente ndaj ujit e njollave. Anësorja dhe ballorja e banakut do të ndërtohet po me të njëjtin material. Në të njëjtin plann ,në lartësinë 38 cm nga suprina e madhe vendoset suprina e vogël me dimensionet 250*30 cm, e cila është pjesë e mbështetjes e vizitorëve. Të gjithë elementët e receptionit të jenë të borduara me material plastik ABS. Pjesë e receptionit është edhe një sirtariere e lëvizshme.</p> <p>Sirtariere me përmasa 40x50*60cm Struktura e sirtarieres do jetë melaminë me trashësi 18 mm. Syprina dhe kapakët ballore të sirtarëve duhet të jenë prej material melamine me spesor 18mm. Bordet anësore të jenë me material plastik ABS. Sirtaria duhet të ketë 4 rrota në fund dhe të mund të lëvizë lirshëm nën tavolinë. Përbëhet nga 3 sirtarë nga te cilët i pari të jetë i pajisur me çelës që të realizojë mbyllje e tij. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarieres.</p>
Elementë të tjerë shtesë:	Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
Standardi ku bazohet:	-
Shembuj foto të produktit:	 <p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</p>
Njësia e produktit:	Copë

19. PERDE ROLLER ME MEKANIZËM

Materiali bazë:	PVC
Përbërja:	70% PVC, 30% Poliester.
Pesha:	410 gr/m ² .(marzh gabimi +/-2 gr/m ²)
Transparente:	Depërton dritën dhe jo diellin
Përqindja e hapjes:	5 % (marzh gabimi +/- 1%)
Rifintura:	Polimer i ngjyrosur
Gjerësia e copës:	200-250-300mm
Spesori:	0.55 mm (marzh gabimi +/- 0.2mm)
Përqindja e dritës:	5% (marzh gabimi +/- 1%)
Tkurrja:	<0.5%
Tjertërsimi i ngjyrës:	Sipas standardeve të aplikueshme
Zjarrdurues:	Po, klasa I (parë).
I CERTIFIKUAR	-si material antibakterial
Elementë të tjerë shtesë:	ne çmontimi të jetë sa më thjeshtë. Të paktohen që të mos gjatë transportit. Ngjyrosim EKO DYS dhe përzierje dhe përcaktimi i saktë i këmbëve dhe strukturës së montimit. AK ne baze te modeleve qe do te paraqiten nga OE. Epërshtatshme edhe për mjedise me lagështirë.
Njësia e produktit:	Metër katror (m ²)
Standardi ku bazohet:	
Shembuj foto të produktit:	 <p>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</p>
Njësia e produktit:	Copë

23.TABELA PËR IDENTIFIKIMIN E DYERVE	
Përmasat:	12x22 cm
Karakteristikat kryesore të produktit:	Materaili i tabelës është plex, spesori 3 mm. Kapur në murë me katër distancor metalik.
Njësia e produktit:	Copë

24.TABELA INFORMACIONI	
Përmasat:	50x70 cm
Karakteristikat kryesore të produktit:	Materaili i tabelës është plex, spesori 3 mm. Kapur në murë me katër distancor metalik.
Njësia e produktit:	Copë

Argumentim: Keto specifikime janë vendosur në bazë të procesverbalit datë “për hartimin e domosdoshmerisë dhe specifikimeve teknike “ nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike si dhe në përputhje me nenin 4 pika 38/b, të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në pikën 2 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“

Ky Procesverbal u ngarkua në SPE nga Njësia e Prokurimit sipas modelit të APP, sipas materialit me nr. 104/9 datë 11.03.2024 me titull ”Ri-dergim Specifikime teknike dhe fondi limit për procedurën e prokurimit :Furnizim Vendosje paisje mjeksore dhe hotelerie për shërbimin e poliklinikës “ të dorëzuar nga Njësia e Posacme e ngritur me urdherin e brendshëm nr.prot.104/1 datë 16.01.2024 i përbërë nga specialiste të fushës.

Njësia e Prokurimit :

- Ina Leka (Sp.e Lartë në Sek. e Prokurimeve) (Juriste)
- Elton Cekaj (Specialist Fushë) (Shef.Sherb Imazheri)
- Edison Rapi (Përgjegjës i Sek. të Prokurimeve) (Ekonomist)